



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 37 datë 2.7.2021

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 63, DATË 28.12.2020 “PËR MIRATIMIN E
BUXHETIT TË VITIT 2021 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM
PËRFUNDIMTAR 2021 - 2023 TË BASHKISË SË SHKODRËS”.**

Këshilli i Bashkisë Shkodër, sot më datë 2.7.2021, në mbështetje të nenit 54 germa dh), të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar, nenit 45 të ligjit nr.68/2017“Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ligji nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar, udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë nr 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, udhëzimi plotësues nr 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2021” të ndryshuar, VKB 63, datë 28.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2021-2023 të Bashkisë Shkodër”, VKB nr 18 date 25.03.2021 “Për vazhdimin e financimit të disiplinave sportive sipas PBA 2021-2023, programi “Sport dhe Argëtim”, përmes metodologjisë LOD, pas mbylljes së funksionimit të Sport Klub “Vllaznia”, si dhe relacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit në VKB nr. 63, datë 28.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2021 - 2023 të

Bashkisë së Shkodrës” pika 1/d “Numri i punonjësve të Bashkisë Shkodër dhe i institucioneve në varësi për vitin 2021”, tabela nr 2 si më poshtë:

Ishte:

Institucioni	Numri i punonjësve të miratuar	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkoder	373	31
Drejtoria e Sherbimeve Bujqesore dhe Pyjore	34	10
Sport Klub "Vllaznia"	21	37
Dega Ekonomike e Kultures	31	
Teatri "Migjeni"	41	
Drejtoria Ekonomike e Arsimit	249	
Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve	239	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit	36	
TOTALI	1,024	78

Bëhet:

Institucioni	Numri i punonjesve të miratuar	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkoder	389	31
Drejtoria e Sherbimeve Bujqesore dhe Pyjore	34	10
Sport Klub "Vllaznia"	0	0
Dega Ekonomike e Kultures	31	
Teatri "Migjeni"	41	
Drejtoria Ekonomike e Arsimit	249	
Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve	239	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit	36	
TOTALI	1,019	41

2. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më datë 01.07.2021

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015
“Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR


Brisela KADIJA



Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Lesha

Miratuar me 30 vota

Vota Pro 28

Vota Kunder 1

Vota Abstenim 1

Zbardhur me datë 5.7.2021